

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Paulo Coelho, filozofia e një shkrimtari që flet me shpirtin dhe kumton se dashuria është shëlbim dhe jet a një udhëtim drejt vetvetes
ADRESA	https://kohajone.com/kultura/paulo-coelho-filozofia-e-nje-shkrimtari-qe-flet-me-shpirtin-dhe-kumton-se-dashuria-eshte-shelbim-dhe-jeta-nje-udhetim-drejt-vetvetes/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 19:41:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 19:39:33 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	038fe725639395244d44e0d576c3f3cf6b6a5c795a3f50c900f6ba6f5345e890
TEKSTI	babcc496ee80511ffc4a2425555a38ee69974dbf0678ddfc7dce5910b4304ecf
PAMJA	027278cc70347beb9d599e798ef68b1a85f5d62b7df81a4b528de1535fd37e44

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	31cdf95156d4ab7bc653f1ebc9891b06162375432e0f3b19db6e54b1f0e6ab0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3aac5177b059e894026952c5b076c374c5dd6b2fda5f20c0a9390b2c535810d8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/31cdf95156d4ab7bc653f1ebc9891b06162375432e0f3b19db6e54b1f0e6ab0

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Paulo Coelho, filozofia e një shkrimtari që flet me shpirtin dhe kumton se dashuria është shëlbim dhe jeta një udhëtim drejt vetvetes

KULTURA E DIEL, 27 SHTATOR 2026 21:39



Paokolo Coelho

Nga Albert Vataj

Ka shkrimtarë që ndërtojnë botë me fjalë dhe të tjerë që, përmes fjalëve, na çojnë drejt botës sonë të brendshme. Paulo Coelho i përket kësaj kategorie të dytë: autorëve që nuk synojnë vetëm të rrëfejnë një histori, por të zgjojnë brenda lexuesit një pyetje, një trazim, një kujtim apo një dëshirë të fjetur. Proza e tij është një udhëtim përtej së dukshmes, atje ku njeriu përballet me frikën, shpresën, dashurinë, vetminë dhe atë nevojë të pushuar për t'i dhënë kuptim ekzistencës.



KOHJA JONE

Na ndiqni në YouTube

SUBSCRIBE

Në universin letrar të Coelho, jeta nuk është një rrugë e shtruar me siguri, por një udhëtim i mbushur me shenja, kryqëzime, humbje dhe zbulime. Njeriu nuk është thjesht ajo që ka qenë, as ajo që të tjerët shohin tek ai; ai është, mbi të gjitha, ajo që guxon të kërkojë, ajo që dëshiron të bëhet dhe ajo që arrin të shpëtojë nga vetvetja, kur frika e mban peng. Prandaj, librat e tij mund të lexohen edhe si udhërrëfyes të një udhëtimi të brendshëm, ku kërkimi i thesarit të jashtëm shndërrohet gradualisht në zbulimin e një pasurie që gjendet brenda nesh.



Kjo është një nga arsyet pse Paulo Coelho ka gjetur një audiencë të gjerë përtej kufijve gjuhësorë dhe kulturorë. Ai shkruan për ato përvoja që e bashkojnë njerëzimin, pavarësisht prejardhjes, besimit apo vendit ku jeton: dëshirën për t'u dashur, frikën e humbjes, etjen për liri dhe ankthin që lind kur jeta nuk përputhet me ëndrrat tona.

Në thelb të kësaj filozofie qëndron bindja se njeriu nuk duhet të heqë dorë nga kërkimi i vetvetes. Sepse ekziston një lloj varfërie që nuk matet me mungesën e pasurisë, por me braktisjen e ëndrrave; një lloj robërie që nuk ka nevojë për pranga, sepse mjafton frika; dhe një lloj humbjeje që ndodh kur njeriu vazhdon të jetojë, por harron arsyen për të cilën dëshironte të jetonte.

LAJMET KRYESORE



Mesazh urgjent i kryeministrit Rama sapo mbërriti nga SHBA (fjala e plotë)



A do të shkojë ambasadori Wendt në Selinë Blu për të takuar Berishën?



Shqipëria fiton me dy gola ndaj Bjellorusisë



Mirë se vjen, Ambasador Wendt!



Presidenti Begaj zbardh takimin me ambasadorin e ri të SHBA, Eric Wendt

TË PËRZGJEDHURA



1 PREMIER LEAGUE - Po sikur Manchester City-t t'i hiqen të gjitha titujt? Si do të ndryshoni...



2 Singapori paguan qytetarët për të lexuar: 15 minuta në ditë në këmbim të parave



3 David Beckham merr 39 milionë paund dividend, marrëveshjet e Kupës së Botës nxisin fitime rekord



4 Ish-ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu te Nikoll Lesi: Nuk ka ministra hije! Balluku-lokomotivë shtetf...



5 Suksesi i menjëhershëm për Muse të Metës: Mjeti i AI tejkalon rivalët si ChatGPT dhe Claude

MË TË LEXUARAT

Dashuria, forca që e shndërron shpirtin

Në romanin e tij më të njohur, Alkimisti, Coelho e trajton dashurinë jo thjesht si një ndjenjë që lind mes dy njerëzve, por si një forcë që ndikon në mënyrën se si e kuptojmë botën dhe veten. Dashuria, në këtë këndvështrim, nuk është një strehë ku njeriu fshihet nga jeta, por një përvojë që e bën atë më të vetëdijshëm për jetën, më të hapur ndaj tjetrit dhe më të gatshëm për t'u përballur me të panjohurën.

Në një nga pasazhet që i atribuohen veprës së tij, dashuria përshkruhet si një forcë që ndryshon dhe përmirëson Shpirtin e Botës, duke e shtyrë njeriun të bëhet më i mirë nga ç'është.

Kjo ide përmban një të vërtetë të rëndësishme njerëzore: dashuria nuk është vetëm kënaqësia e të qenit pranë dikujt, por edhe përgjegjësia për atë që bëhemi në praninë e tij. Ajo na zbulon anë të vetes që nuk i njihnim, na përball me dobësitë që përqipeshim t'i fshihnim dhe na mëson se afërsia e vërtetë nuk kërkon përsosmëri, por sinqeritet, mirëkuptim dhe gatishmëri për t'u rritur.

Të duash do të thotë të mos e konsiderosh tjetrin pronë, të mos e burgosësh brenda pritshmërive të tua dhe të mos e kthesh ndjenjën në një marrëveshje të heshtur ku secili duhet të përmbushë dëshirat e tjetrit. Dashuria që e pasuron shpirtin nuk e zhduk lirinë; përkundrazi, e mbron atë. Nuk e zvogëlon njeriun, por i jep hapësirë të bëhet më i plotë.

Në këtë kuptim, dashuria është një lloj alkimie: ajo nuk e shndërron plumbin në ar, por mund ta shndërrojë frikën në guxim, egoizmin në përkujdesje dhe vetëkënaqësinë në dëshirë për të kuptuar. Ajo nuk na premtun një jetë pa vuajtje, por na jep një arsye për të mos u dorëzuar përballë saj.

Sepse njeriu që dashuron nuk është domosdoshmërisht njeriu që nuk vuan. Shpesh, është pikërisht ai që ka mësuar ta përballojë dhimbjen pa e kthyer atë në ligësi, ta pranojë humbjen pa e mohuar bukurinë e asaj që ka jetuar dhe të vazhdojë të besojë, edhe pasi përvoja i ka treguar se asgjë njerëzore nuk është e përvetshme.

Vetmia, ajo plagë që nuk shihet, por që mund ta gërryjë njeriun nga brenda

Por, krahas dashurisë, një tjetër shqetësim i madh përshkon mendimin letrar të Paulo Coelho: vetmia. Jo thjesht vetmia si mungesë e pranisë fizike të dikujt, por ajo gjendje e brendshme në të cilën njeriu nuk arrin më të komunikojë me botën, nuk gjen një vend ku të mbështesë dhimbjen e vet dhe nuk ka kujt t'ia besojë atë që e mundon.

Ka vetmi që lind nga mungesa dhe vetmi që lind nga tepria; nga mungesa e njerëzve, por edhe nga pamundësia për t'u kuptuar mes tyre. Ka vetmi që zgjedhim për të dëgjuar veten dhe vetmi që na imponohet, duke na lënë përballë një zbrazëtie të cilën asnjë zhurmë e jashtme nuk mund ta mbushë. E para mund të jetë një strehë e mendimit, një laborator i ndërgjegjes, një hapësirë ku njeriu rindërton ekuilibrin e vet. E dyta mund të kthehet në një plagë të heshtur, që e shteron shpirtin pak nga pak.

Një thënie që i atribuohet Coelho e shpreh këtë dhimbje me një gjuhë të drejtpërdrejtë:

"Qeniet njerëzore mund të përballojnë një javë pa ujë, dy javë pa ushqim, vite të tëra të pastrehë, por jo vetminë. Ajo është më e keqja e të gjitha torturave, më e keqja e të gjitha vuajtjeve."

Pavarësisht nga karakteri i saj hiperbolik, kjo thënie prek një të vërtetë të thellë psikologjike: njeriu është qenie marrëdhëniesh. Ai nuk jeton vetëm përmes frymëmarjes, ushqimit dhe strehës, por edhe përmes njohjes, përkatësisë dhe ndjenjës se ekzistenca e tij ka rëndësi për dikë. Të jesh i parë, i dëgjuar, i pranuar pa pasur nevojë të shtirësh një tjetër vetvete, është një prej nevojave më themelore të shpirtit njerëzor.

Mund të kesh një shtëpi dhe të mos kesh strehë shpirtërore. Mund të jesh mes qindra njerëzve dhe të mos gjesh një të vetëm me të cilin të ndash atë që të mundon. Mund të kesh sukses, njohje, pasuri dhe duartrokitje, por të kthehesh në mbrëmje në një zbrazëti që nuk e mbush dot asgjë nga ato që bota i quan fitore.

Kjo është drama e vetmisë së padukshme: ajo nuk shfaqet gjithmonë në fytyrën e njeriut, nuk matet me numrin e telefonatave dhe as me numrin e miqve. Ndonjëherë, njeriu më i vetmuar është ai që di të buzëqeshë më bindshëm, sepse ka mësuar ta fshehë mungesën pas një paraqitjeje të zakonshme.

Megjithatë, vetmia nuk duhet ngatërruar me të qenit vetëm. Ka njerëz që e kërkojnë vetminë për të menduar, për të krijuar, për të lexuar ose për t'u pajtuar me veten. Ka të tjerë që e përjetojnë atë si një dhomë pa dyer. Dallimi qëndron te liria: kur vetminë e zgjedhim, ajo mund të na pasurojë; kur na mbyll brenda vetes dhe na shkëput nga çdo lidhje kuptimplotë, ajo mund të bëhet një barrë e rëndë.

Ndoshta, ajo që njeriu ka më shumë nevojë të dëgjojë nuk është se nuk do të jetë kurrë vetëm, por se vetmia e tij nuk është domosdoshmërisht një fat i përhershëm. Ndonjëherë mjafton një njeri që dëgjon pa gjykuar, një dorë që nuk tërhiqet në çastin e vështirë, një fjalë që mbërrin pikërisht kur mendon se askush nuk e ka vënë re dhimbjen tënde.

Sepse, në fund të fundit, të shpëtosh dikë nga vetmia nuk do të thotë gjithmonë t'i japësh këshilla. Ndonjëherë do të thotë thjesht t'i dëshmosh se prania e tij ka vlerë.

Kur jeta hap një derë dhe e papritura ndryshon gjithçka

Në filozofinë e Coelho, jeta nuk është një vijë e drejtë, e parashikueshme, ku çdo ngjarje i bindet planeve tona. Ajo është një rrjedhë që herë na çon drejt brigjeve të njohura, herë na përplas me të papriturën dhe herë na detyron të rishikojmë gjithçka që mendonim se dinim për veten.

Ka periudha kur ditët ngjajnë me njëra-tjetrën, kur asgjë nuk duket se lëviz dhe kur shpirti mësohet me të njëjtat emocione, të njëjtat shqetësime dhe të njëjtin horizont. Pastaj, papritur, ndodh diçka: një takim, një fjalë, një libër, një

udhëtim, një dashuri, një humbje apo një mundësi që nuk e kishim parashikuar. Dhe ajo që dukej e palëvizshme nis të ndryshojë.

Një tjetër pasazh që i atribuohet Coelhos e përshkruan këtë përmbysje të papritur të përjetimit:

"Një person mund të kalojë ditë, javë, muaj, vite, pa asnjë ndjenjë të re. Pastaj ndodh të hapet një derë, dhe një ortek pozitiv hyn në të. Në një moment nuk kishe asgjë, në tjetrin, ke më shumë sesa mund të përballosh."

Metafora e derës është domethënëse. Dera përfaqëson mundësinë, por edhe pragun që duhet kapërcyer. Ajo nuk është vetëm një hapje drejt asaj që vjen, por edhe një ndarje nga ajo që kemi qenë. Të kalosh përmes saj do të thotë të pranosh se jeta mund të na ofrojë diçka përtej përvojës sonë, por edhe se çdo ndryshim kërkon njëfarë guximi.

Ndonjëherë, ajo që na mungon nuk është mundësia, por gatishmëria për ta njohur atë. Frika na mëson të qëndrojmë aty ku jemi, edhe kur vendi ku ndodhemi nuk na përmbush më. Na bind se e njohura, sado e pakënaqshme, është më e sigurt se e panjohura. Dhe kështu, pa e kuptuar, mund të shndërrohemi në roje të një jete që nuk na përket më plotësisht.

Coelho na fton ta shohim të papriturën jo vetëm si një ndërprerje të rendit të zakonshëm, por edhe si një mundësi për të zbuluar kapacitete që nuk e dinim se i zotëronim. Megjithatë, jo çdo derë që hapet na çon drejt lumturisë dhe jo çdo ndryshim është përmirësim. Urtësia qëndron në aftësinë për të dalluar atë që na zgjeron si qenie njerëzore nga ajo që vetëm na mahnit për një çast.

Sepse jeta nuk ndryshon vetëm kur na ndodh diçka e jashtëzakonshme. Ajo ndryshon edhe kur ne fillojmë ta shohim ndryshe atë që kemi përpara.

Flaka e shenjtë e çmendurisë: të mos bëhesh rob i së zakonshmes

Një nga idetë më tërheqëse në botën e Coelhos është nevoja për të ruajtur brenda vetes atë pjesë të papërmbajtur që guxon të ëndërrojë, të pyesë, të kundërshtojë dhe të mos pajtohet me një jetë të reduktuar në përsëritje.

Ai e shpreh këtë ide përmes figurës së "flakës së shenjtë të çmendurisë", një metaforë për atë energji të brendshme që e mbron njeriun nga tharja e dëshirave, nga nënshtrimi ndaj zakonit dhe nga frika e gjykimit të të tjerëve.

"Çdo njeri duhet të mbajë të gjallë brenda tij flakën e shenjtë të 'çmendurisë'. Dhe duhet të sillet si një njeri i zakonshëm."

Kjo thënie, e marrë si një metaforë letrare, mbart një paradoks domethënës. Njeriu duhet të jetë pjesë e botës pa e lejuar botën t'ia shuajë individualitetin; të jetojë mes të tjerëve pa e dorëzuar të drejtën për të qenë vetvetja; të përmbushë përgjegjësitë e përditshme pa e varrosur brenda tyre ëndrrën që i jep kuptim ekzistencës.

Çmenduria, në këtë kontekst, nuk është humbje e arsyes dhe as glorifikim i papërgjegjshmërisë. Është ajo guximësi krijuese që i lejon njeriut të mendojë përtej kufijve të zakonshëm, të mos e marrë të mirëqenë çdo rregull dhe të mos e ngatërrojë përshtatjen me nënshtrimin.

Historia e njerëzimit është e mbushur me njerëz që dikur janë konsideruar ëndërrimtarë të pamundur, sepse kanë guxuar të përfytyrojnë atë që të tjerët nuk arrinin ta shihnin. Shpikësi, artisti, shkrimtari, eksploruesi dhe mendimtari shpesh nisen nga një pakënaqësi me kufijtë e së njohurës. Ata nuk kënaqen me përgjigjet që kanë trashëguar, por kërkojnë pyetjet që ende nuk janë bërë.

Edhe në jetën e zakonshme, kjo flakë është e domosdoshme. Ajo është dëshira për të filluar nga e para, për të mësuar diçka të re, për të dashuruar pas zhgënjimit, për të falur pa e mohuar dhimbjen dhe për të mos lejuar që dështimi i djeshëm të bëhet kufiri i së nesërmes.

Rreziku më i madh nuk është të dukesh i pazakontë në sytë e të tjerëve. Rreziku është të kalosh një jetë të tërë duke u përpjekur të jesh pikërisht ai që të tjerët presin prej teje, deri në çastin kur nuk arrin më të dallosh dëshirat e tua nga ato që të janë imponuar.

Të ruash flakën e brendshme do të thotë të mos e traditosh krejtësisht fëmijën që dikur ke qenë, atë që besonte se bota ishte më e gjerë se muret e dhomës, se e pamundura mund të vihej në provë dhe se jeta nuk ishte vetëm një varg detyrimesh, por edhe një hapësirë e pafund zbulimi.

E tashmja, vendi ku e kaluara mund të marrë një kuptim të ri

Në fund të këtij udhëtimi shpirtëror që përshkon veprën e Coelhos, shfaqet një ide që prek drejtpërdrejt mënyrën se si njeriu e përjeton kohën: marrëdhënia mes së kaluarës, së tashmes dhe së ardhmes.

Ne shpesh jetojmë të lidhur pas asaj që ka ndodhur. Rikthehemi te gabimet, te humbjet, te fjalët që nuk duhej t'i kishim thënë dhe te mundësitë që nuk ditëm t'i shfrytëzonim. E kaluara bëhet një gjykatës që na ndjek pas, ndërsa pendimi kthehet në një mënyrë të dhimbshme për ta ripërfjetuar atë që nuk mund të ndryshohet më.

Por njeriu nuk është vetëm shuma e gabimeve të veta. Ai është edhe aftësia për t'i kuptuar ato, për të nxjerrë mësimë prej tyre dhe për të mos i përsëritur. E kaluara nuk mund të fshihet, por marrëdhënia jonë me të mund të ndryshojë. Ajo që dikur e shihnim vetëm si dështim, me kalimin e kohës mund të na zbulojë një mësim; ajo që na dukej një humbje e pakthyeshme, mund të na mësojë të vlerësojmë atë që ende kemi.

Një tjetër mendim që i atribuohet shkrimtarit e përmbledh këtë ide:

"Nuk është ajo që ju keni bërë në të kaluarën, ajo që do të ndikojë në të tashmen, por ajo që ju bëni në të tashmen është ajo që do të shpëtojë të kaluarën, dhe natyrisht do të ndryshojë të ardhmen."

Kjo nuk do të thotë se veprimet e së tashmes mund t'i fshijnë pasojat e së kaluarës apo t'i zhbëjnë padrejtësitë që kemi

përjetuar. Disa plagë mbeten, disa humbje nuk kompensohen dhe disa gabime nuk mund të korrigjohen plotësisht. Por njeriu mund të zgjedhë nëse do të vazhdojë të jetojë si i burgosur i asaj që ka ndodhur apo do të përpiqet të ndërtojë një marrëdhënie më të vetëdijshme me atë që vjen.

E tashmja është e vetmja hapësirë ku mund të veprojmë. Nuk mund ta ndryshojmë dje, por mund të ndryshojmë mënyrën se si e mbajmë atë brenda nesh. Nuk mund t'i kthejmë fjalët e thëna, por mund të kërkojmë falje. Nuk mund t'i rikthejmë të gjitha mundësitë e humbura, por mund të mos e humbim edhe mundësinë që kemi sot.

Këtu qëndron një prej dallimeve më të rëndësishme mes pendimit që na paralizon dhe përgjegjësisë që na çliron. I pari na mban të lidhur pas asaj që nuk mund të ndryshojmë; e dyta na kthen te ajo që ende mund të bëjmë.

Të jetosh në të tashmen nuk do të thotë të harrosh të kaluarën dhe as të heqësh dorë nga e ardhmja. Do të thotë të mos e lejosh asnjërin të të grabisë plotësisht të vetmen kohë ku jeta po ndodh: këtë çast.

Paulo Coelho dhe arti i të mos hequrit dorë nga vetvetja

Universi letrar i Paulo Coelho ndërtohet rreth një kërkimi që nuk përfundon me gjetjen e një thesari, me përmbushjen e një dëshire apo me arritjen e një destinacioni. Ai na çon drejt një pyetjeje më të thellë: çfarë ndodh me njeriun gjatë rrugës që përshkon për t'u bërë ai që dëshiron të jetë?

Në Alkimistin, udhëtimi i jashtëm shndërrohet në një udhëtim të brendshëm. Në reflektimet mbi dashurinë, ndjenja bëhet një mundësi për transformim. Në mendimet mbi vetminë, shfaqet nevoja për lidhje njerëzore. Në metaforën e flakës së çmendurisë, mbrohet liria për të ëndërruar. Ndërsa në marrëdhënien me të kaluarën, e tashmja shfaqet si mundësia për të vepruar, për të riparuar dhe për të filluar përsëri.

Megjithatë, filozofia e tij nuk duhet lexuar si një formulë magjike që premtan se çdo ëndërr do të bëhet realitet, se çdo dashuri do të triumfojë apo se çdo plagë do të shërohet vetëm me forcën e dëshirës. Jeta është më e ndërlikuar se kaq. Ajo përmban rrethana që nuk varen prej nesh, padrejtësi që nuk i kapërcejmë vetëm me optimizëm dhe humbje që kërkojnë kohë, mbështetje dhe pranim.

Vlera e një letërsie të tillë nuk qëndron te premtimi i një bote pa vuajtje, por te nxitja për të mos e humbur aftësinë për të kërkuar kuptim edhe kur vuajtja është e pranishme. Ajo na kujton se shpresa nuk është garanci për një përfundim të lumtur, por një mënyrë për të mos ia dorëzuar plotësisht të ardhmen dëshpërimit të së tashmes.

Dhe ndoshta pikërisht këtu qëndron arsyeja pse Coelho vazhdon të lexohet nga miliona njerëz: ai u flet atyre që janë në udhëkryq, atyre që kanë humbur diçka, atyre që ende nuk e kanë gjetur vendin e tyre në botë dhe atyre që, pavarësisht gjithçkaje, nuk janë pajtuar me idenë se jeta duhet të jetë vetëm një përsëritje e ditëve.

Ai na fton të mos e ngatërrojmë rehatinë me lumturinë, të mos e quajmë siguri çdo qëndrim në vend dhe të mos e konsiderojmë të pamundur atë që ende nuk kemi guxuar ta provojmë.

Sepse jeta nuk është vetëm ajo që na ndodh, por edhe mënyra se si i përgjigjemi asaj që na ndodh. Nuk jemi të lirë të zgjedhim çdo ngjarje, por shpesh mund të zgjedhim qëndrimin, përgjegjësinë dhe hapin e radhës.

Në përmbyllje, filozofia e Paulo Coelho mund të lexohet si një thirrje për të mos e braktisur njeriun brenda nesh. Të duam pa e kthyer dashurinë në pranga. Të përjetojmë vetminë pa e shpallur atë fat të përjetshëm. Të ruajmë flakën e ëndrrave pa u shkëputur nga përgjegjësitë e jetës. Të shohim të kaluarën pa u bërë robër të saj dhe të përqafojmë të tashmen pa e humbur shpresën për të ardhmen.

Në fund të fundit, udhëtimi më i gjatë nuk është ai që përshkon distanca, dete e shkretëtira. Është udhëtimi që njeriu bën drejt vetvetes, duke kaluar nëpër frikërat, gabimet, dashuritë, humbjet dhe zbulimet e veta.

Dhe nëse gjatë këtij udhëtimi arrijmë të mos e humbasim aftësinë për të dashur, për të ëndërruar, për të ndryshuar dhe për të kërkuar një kuptim të ri për jetën, atëherë, pavarësisht sa larg kemi mbërritur, nuk e kemi humbur rrugën.

Sepse thesari më i rëndësishëm nuk është gjithmonë ajo që gjejmë në fund të udhëtimit, por njeriu që bëhemi duke e përshkuar atë.

ETIKETA ALBERT VATAJ PAULO COELHO

MË SHUMË NGA KULTURA



Blendi Gonxhja nxjerr
“Valltare” e Kinostudios, nga
Kino e Kulturës



Feja, motivim dhe balsam
qënsije



Sherlock Holmes, miti që nuk i
takon vetëm penës që e krijoi,
por edhe

nija e kujteses ...

por eam...



Naim Doda dhe shkolla shqipe në Firence: atdhedashuria që nis nga Abe...



Vendim i qeverisë, fshati Vuno shpallet pasuri kulturore e paluajtshm...



Brad Pitt flet për përvojën ‘prekëse’ me qenin aktor

I AJMET F FUNDIT

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.